Numër: 01-216 Datë: 01.04.2026

Në mbështetje të neneve 6,8,9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren Nr. 01/196 e punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2026 merr:

V E N D I M

I. **Akreditohet dhe Validohet** Qendra për Aftësim Profesional QAP - Gjakovë Adresa: Rr.Mbretëresha Teuta" pn.50 000 Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare (31.03.2026 - 31.12.2029), me kualifikimin:

- **Nëpunës i Kontabilitetit,** niveli IV sipas Kornizës Kombëtare Të Kualifikimeve (KKK), me numër total të kredive 15, kualifikim i bazuar në: Kualifikime Kombëtare Profesionale, (D). Qendra për Aftësim Profesional QAP - Gjakovë Numri i kandidatëve brenda një grupi 12 kandidatë për një grup. Brenda vitit 2 grupe në total 24 kandidatë brenda vitit.

II. Obligohet Institucioni të plotësoj kushtet bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues dhe kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi.

III. Institucioni mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit Qendra për Aftësim Profesional QAP - Gjakovë, me Nr. Prot: 01-49, 07.02.2025 të parashtruar në AKK, për riakreditim dhe rivalidim të institucionit në Gjakovë, për kualifikimin: **Nëpunës i Kontabilitetit** Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka caktuar ekipet e eksperteve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për riakreditim dhe rivalidim për kualifikimet si më lartë.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit 27.11.2025 për kualifikimin: **Nëpunës i Kontabilitetit** dhe vizitës të realizuar me datën 02.12.2025, pas përfundimit të procesit vlerësues, raportet janë realizuar me datë: 12.12.2025. Bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 31.03.2026.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë mbështetur në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit si: aplikacionet për validim të kualifikimeve, aplikacionet për akreditim të institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni si dhe të gjeturave me rastin e realizimit të vizitave së realizuar tek pala aplikuese.
AKK bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr/03/L-060 Për Kualifikimet Kombëtare dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë është e obliguar të realizoj procesin e monitorimit dhe të raportoj tek Këshilli Drejtues i AKK-së.

Këshilli Drejtues i AKK-së gjatë vendimmarrjes për riakredimit në prapaveprim ka marr parasysh faktin se institucioni kishte aplikuar brenda afatit ligjor për riakreditimin e programit.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së, referuar dispozitave ligjore, rekomandimeve të ekipit të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese përfundimtare për akreditim dhe validim të institucionit aplikues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.*

Dr. Besim Mustafa
Kryetar i Këshillit Drejtues
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve

Vendimi u dërgohet:

- Institucioni Qendra për Aftësim Profesional QAP - Gjakovë
- Arkivit të AKK.